

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5
31.12.2014

NR. VENDIMI 16
27.07.2015

V E N D I M

“Per Konfiskim Pasurie”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, e perbere prej

GJYQTARE: Etleva DEDA

GJYQTAR: Dritan HALLUNAJ

GJYQTAR: Fran PRENDI

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Jerina SKRAPARI**, sot ne date 27.07.2015, ora 12.00, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen penale Nr.5/32 Regj. me:

KERKUESE: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, perfaqesuar nga **prokurori Edvin KONDILI**.

KUNDER:

SHTETASVE:

1- S. G., i biri i M. dhe i Sh., i datelindjes xxxx, lindur dhe banues ne xxxx; i perfaqesuar nga avokati Xh. M., anetar i Dhomes se Avokatise xxxx, me Nr. xxxx License, Nr. xxxx NIPT-i, i emeruar si perfaqesues me prokuren e posacme me Nr. xxxx Rep., Nr. xxxx Kol., date xxxx, te perpiluar perpara noterit E. A..

2- M. G., i biri i S. dhe i F., i datelindjes xxxx, lindur dhe banues ne xxxx; i perfaqesuar nga avokati Xh. M., anetar i Dhomes se

Avokatise xxxx, me Nr. xxxx License, Nr. xxxx NIPT-i, i emeruar si perfaqesues me prokuren e posacme me Nr. xxx Rep., Nr. Xxx Kol., date xxxx, te perpiluar perpara noterit E. A..

3- R. G., i biri i S. dhe i F., i datelindjes xxxx, lindur dhe banues ne xxxx; i perfaqesuar nga avokati Xh. M., anetar i Dhomes se Avokatise xxxx, me Nr. xxxx License, Nr. xxxx NIPT-i, i emeruar si perfaqesues me prokuren e posacme me Nr. xxx Rep., Nr. xxx Kol., date xxxx, te perpiluar perpara noterit E. A..

OBJEKTI:

I. Konfiskimin e shumes monetare, te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., te perbere:

1. Prej **xxxx (xxxx) euro**, qe ndodhen ne Banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., e datelindjes xxxx.

2. Prej **xxx (xxxx) euro**, ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx, ne Banken xxxx.

3. Prej **xxxx (xxxx) euro**, ne emer te shtetasve R. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx, ne Banken xxxx.

II. Per administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet Z. K. Xh., i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara, prane Ministrise se Financave Tirane. Per ekzekutimin e ketij konfiskimi te ngarkohet Zyra e Perambarimit Gjyqesor .

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.10192, date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

Ne perfundim te gjykimit, te zhvilluar ne prani te prokurorit Edvin Kondili dhe te perfaqesuesit te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., avokatit Xh. M., gjykata, pasi e gjeti veten kompetente per te gjykuar dhe vendosur mbi kerkesen e paraqitur, ne baze te nenit 7 te Ligjit Nr.10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, pasi degjoi bisedimet perfundimtare te paleve, ku:

Prokurori Edvin Kondili kerkoi:

- I. Heqjen dore nga gjykimi i kerkeses se padise dhe pushimin e gjykimit ndaj shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., pasi gjate gjykimit nuk u be e mundur te provohet se shuma prej xxxx euro eshte fituar nga veprimtari e paligjshme.
- II. Revokimin e sekuestros per shumat monetare:
 1. Prej **xxxx (xxxx) euro**, qe ndodhen ne Banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., e datelindjes xxxx.
 2. Prej **xxxx (xxxx) euro**, ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx, ne Banken xxxx.
 3. Prej **xxxx (xxxx)**, ne emer te shtetasve R. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx, ne Banken xxxx.

Perfaqesuesi i shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., avokati Xh. M. kerkoi:

Jam dakort me prokurorin dhe kerkoi pushimin e gjykimit te kerkeses per konfiskim.

V E R E N

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, ne date xxxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx, Viti xxxx, ne ngarkim te shtetasve nen hetim M. G., S. G. dhe R. G., si persona te dyshuar per kryerje te vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres

penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimi pasuror ishte rrjedhoje e procedimit penal Nr.xxx, viti xxx, te rregjistruar ne Prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor xxxx.

Nga materiali hetimor, qe Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor xxxx i dergoi Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, rezultoi sa me poshte:

Shtetasi M. G. ne date xxxx depozitoi ne Banken xxxx, ne llogarine rrjedhese me Nr. xxxx, shumen prej xxxx (xxxx) euro, ne date xxxx shumen prej xxxx (xxxx) euro, ne date xxxx shumen prej xxxx (xxxx) euro, te deklaruar prej tij si perfitime nga emigracioni dhe, po ne date xxxx shumen prej xxxx (xxxx) euro te deklaruar si shume e marre hua nga shtetasi L. B..

Shtetasit R. G. dhe S. G., ne date xxxx çelen ne Banken xxxx llogarine bankare me Nr. xxxx duke depozituar ne te shumen prej xxxx (xxxx) dhe deklaruar si burim te saj emigracionin.

Ne date xxxx, shtetasi M. G. transferoi shumen monetare prej

Xxxx (xxxx) euro, nga llogaria e tij ne llogarine bankare te shtetases R. R., me profesion notere (anetare e Dhomes se Noterise xxxx), ne funksion te permbylljes se kontraten e shitblerjes se pasurise se paluajtshme te lidhur prej tij me pale shitese shtetasin J. S.. Aktualisht shuma monetare, prej xxxx euro, ndodhet ne Banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., nen sekuestro.

Gjithashtu prane Bankes xxxx, u konstatuan edhe nje shume prej xxx (xxxx) euro ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx dhe, nje shume prej xxxx (xxxx) euro ne emer te shtetasve R. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx (e cila mbeti pas transferimit prej shumes xxxx euro te shumes prej xxxx euro, ne funksion te plotesimit te shumes prej xxxx euro).

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor xxxx, pasi ngriti dyshimin e arsyeshem, te bazuar ne prova (sipas saj) se, transaksioni financiar i sipercituar, ne funksion te kontrates se shitblerjes se pasurise se paluajtshme, me pale shitese shtetasin J. S., kryhej ne funksion te pastrimit te produkteve te rrjedhura nga veprimtari e kundraligjshme, e parashikuar si veper penale ne nenin 287 te Kodit Penal, vendosi masen e sekuestros preventive mbi llogarite bankare me shumet perkatese te pershkruara me siper, ne funksion te procedimit penal me Nr. xxx viti xxxx.

Gjithashtu, pasi çmoi se ndodhej para rasteve te parashikuara nga Ligji Nr.10192, date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te

organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, materialin hetimor i’a kaloi Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, mbi kerkesen e Prokurorise, me vendimin e saj Nr. xx date xxxx, nder te tjera ka vendosur:

I. *“Vendosjen e mases se sekuestros mbi shumat monetare te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., e konkretisht te:*

1. Shumes xxxx (xxxx) euro, qe ndodhen ne banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., e datelindjes xxxx.

2. Shumes xxx (xxx) euro, ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx, ne banken xxxx.

3. Shumes xxxx (xxxx) euro, ne emer te shtetasve R. G. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx, ne banken xxxx.

II. *Pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se sekuestros deri ne dhenien e nje vendimi gjyqesor penal per revokim apo shuarje te mases se sekuestros preventive.*

III. *Per ekzekutimin e vendimit te sekuestros ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor ne xxxx dhe, per administrimin e pasurise se sekuestruar, administratori K. Xh., ne Agjensine e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara, prane Ministrise se Financave Tirane...”*

Ky vendim eshte zbatuar me date 07.04.2014 dhe ishte i vlefshem per gjashte muaj, gjer me date 07.10.2014.

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane vendosi zgjatje te afatit te sekuestros, duke e bere te vlefshme deri me date 07.01.2014.

Me date xxxx, ne baze te neneve 3 deri ne 7, 14 deri ne 22 e vijues te ligjin Nr.10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane paraqiti para kesaj Gjykate, kerkesen me objekt konfiskimin e llogarive bankare te sekuestruara me vendimin Nr. xxx date xxxx.

Ne fillim te shqyrtimit gjyqesor, prokurori pretendoi se derdhja e shumave te konsiderueshme ne euro, ne llogari bankare, brenda nje periudhe kohe shume te shkurter, duke deklaruar si burim te krijimit te tyre emigracionin, sherben si

baze per ngritjen e dyshimit te arsyeshem, te bazuar ne prova, per kryerjen nga shtetasit M. G., S. G. dhe R. G., te vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Duke qene shtetasit M. G., S. G. dhe R. G., te dyshuar per kryerjen e nje vepre te tille, ne baze te nenit 3 pika 1 germa “d” te Ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, jane subjekt i zbatimit te tij dhe per shkak se nuk provohet prejadhja e ligjshme, pasuria e tyre duhet te konfiskohet.

Ne funksion te provueshmerise se pretendimeve dhe kerkeses ne gjykim, prokurori paraqiti si prove aktet qe kishin te benin me regjistrimin e procedimit penal ne Prokurorine prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor xxxx, perfshire edhe vendimin e saj per vendosjen e sekuestros mbi llogarine bankare ne shumen prej xxxx euro dhe te çdo llogarie tjeter qe i perkiste shtetasve S., M. dhe R. G.; dokumentet bankare ku dokumentohej çelja e llogarive dhe transaksionet e kryera me to; te dhenat e marra nga bankat e nivelit te dyte dhe zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rrethe, ne lidhje me depozita apo pasuri te paluajtshme ne emer te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G. (me rezultate negative), deklarimet e tyre me cilesine e personave nen hetim, si dhe vendimin e Prokurorise se Pergjithshme per shfuqizimin e vendimit te pushimit te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor xxxx, per procedimin penal nr. xxx te vitit xxxx, etj.

Ne baze te ligjit te mesiperem , konkretisht te nenit 21 pika 3 te tij, barra e proves per te provuar se vlera monetare prej xxxx euro te sekuestruara eshte fituar ne menyre te ligjshme u perket shtetasve S., M. e R. G..

Prej perfaqesuesit te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., avokatit Xh. M., u pretendua dhe u paraqiten prova, si me poshte shenuar:

Shtetasi M. G. rezulton i padenuar si ne shtetin shqiptar ashtu edhe ne shtetin grek. Keto fakte rezultojne te provuara me Vertetimin e Gjendjes Gjyqesore Nr. x Prot. date xxxx te Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, si dhe me shkresen Nr. Prot. xxxx te Departamentit te Gjendjes Gjyqesore te Ministrise se Drejtesise se shtetit grek. Ky shtetas rezulton te jete pajisur me dokumenta te rregullta dhe te drejte pune ne shtetin grek qe ne vitin 2002, c’ka provohet me shkresen Nr. Prot. xxxx e leshuar nga Qarku Attiki i Republikes se Greqise, Drejtoria e Emigracionit Attiki e Siperme, e leshuar me date xxxx. U paraqiten si prova rinovimet e lejeve te qendrimit ne shtetin grek, deri ne lejen e fundit 10 vjecare, e cila skadon ne vitin 2022. U pretendua qe ky shtetas ka punuar pune te ndryshme ne ekonomine informale, dhe per pjesen me te madhe nuk ka dokumenta te rregullta, prrtdim ky i paprovuar.

Prej perfaqesuesit Xh. M. u paraqiten disa shkresa nga Ministria e Financave dhe Ekonomise ku vertetohen pasqyrat per pagesen dhe tatimin mbi te ardhurat si person fizik ne baze te deklarimit fillestar per vitet kalendarike 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2013, ku ne total rezulton se te ardhurat per keto vite jane xxxx (xxxx) euro.

Shtetasi R. G. rezulton i padenuar si ne shtetin shqiptar ashtu edhe ne shtetin grek. Keto fakte rezultojne te provuara me Vertetimin e Gjendjes Gjyqesore Nr.xxx Prot. date xxxx te Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, si dhe me shkresen Nr. Prot. xxxx te Departamentit te Gjendjes Gjyqesore te Ministrise se Drejtesise se shtetit grek. U paraqiten disa shkresa nga Ministria e Financave dhe Ekonomise ku vertetohen pasqyrat per pagesen dhe tatimin mbi te ardhurat si person fizik ne baze te deklarimit fillestar per vitet kalendarike 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 e 2014.

Shtetasi S. G. rezulton i padenuar si ne shtetin shqiptar ashtu edhe ne shtetin grek. Keto fakte rezultojne te provuara me Vertetimin e Gjendjes Gjyqesore Nr.x Prot. date xxxx te Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, si dhe me shkresen Nr. Prot. xxxx te Departamentit te Gjendjes Gjyqesore te Ministrise se Drejtesise se shtetit grek. Ky shtetas rezulton te jete pajisur me dokumenta te rregullta dhe te drejte pune ne shtetin grek qe ne vitin 2002, c'ka provohet me shkresen Nr. Prot. xxxx e leshuar nga Qarku Attiki i Republikes se Greqise, Drejtoria e Emigracionit Attiki e Siperme, e leshuar me date xxxx. U paraqiten disa shkresa nga Ministria e Financave dhe Ekonomise ku vertetohen pasqyrat per pagesen dhe tatimin mbi te ardhurat si person fizik ne baze te deklarimit fillestar per vitet kalendarike 2003 e ne vazhdim.

Ne baze te kontrates se huase Nr. xxx Rep., Nr. xxx Kol., te perpilur me date xxxx perpara noterit B. Xh., anetar i Dhomes se Noterise xxxx, rezulton se huadhenesi L. B. i ka dhene hua huamarresit M. G. shumen prej xxxx euro. Ky fakt dhe aktiviteti i shtetasit L. B. u provua ne gjykim nga deshmia e tij e dhene perpara gjykates, si dhe nga pasqyrat financiare te "xxxx" per vitet 2010, 2011, 2012 e 2013.

Shtetasi M. G., me date xxxx i ka marre hua shtetasit E. M. shumen prej xxxx euro, fakt i cili provohet me Deklaraten Nr. xxx Rep., Nr. xxx Kol., te perpiluar me date xxxx, perpara noterit E. A., anetar i Dhomes se Noterise xxxx, ku kane deklaruar si huamarresi dhe huadhenesi.

Sipas deklarimeve te shtetasit M. G., dhene ne date xxxx, shuma prej xxxx euro, depozituar ne Banken xxxx, Dega

xxxx, nuk i perkiste plotesisht atij. Nga kjo shume, xxxx euro ishte e ardhur e tij nga emigracioni, xxxx euro i perkiste babait te tij S. dhe vellait R., gjithashtu e ardhur nga emigracioni, ndersa xxxx euro shume e marre borxh prej tij, nga shtetasi L. B. (i cili ka nje firme xxxx ne Tirane) sipas Kontrates se Huase Nr. xxxx Rep, Nr. xxx Kol date xxxx. Depozitimi i shumes prej xxxx euro ne llogarine bankare te shtetases R. R. u be ne funksion te Kontrates se Shit-Blerjes, me kusht, me Nr. xxx Rep, Nr. xxx Kol date xxxx per blerjen e objektit “xxxx” ne pronesi te shtetasit J. S.. Ky i fundit e nxori ne shitje objektin per shkak te mospagimit te kredise se marre prej tij ne banke.

Te njejtin deklarim kane bere edhe shtetasit S. G. dhe R. G. ne date xxxx.

Gjate shqyrtimit gjyqesor te kesaj ceshteje, perfaqesuesi i Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, prokurori Edvin Kondili, per te percaktuar bilancin financiar dhe pasuror te te paditurve, mbi bazen e provave shkresore te paraqitura prej paleve ne kete gjykim, kerkoj kryerjen e nje ekspertimi kontabel.

Per kete arsye, bazuar ne nenet 224/a e vijues te K.Pr.Civile, gjykata e pranoi kerkesen e prokurorit, per te thirrur nje ekspert kontabel per te bere te mundur vleresimin e gjendjes financiare te te paditurve S. G., M. G. e R. G. (pasuria e te cileve kerkohej te konfiskohej), duke patur si qellim llogaritjen e sakte te te ardhurave te ligjshme si dhe shpenzimeve te te gjitha natyrave, per te nxjerre shumen monetare ne disponim te te paditurve ne daten xxxx, date ne te cilen eshte kryer edhe transaksioni bankar, objekt i kerkeses per konfiskim.

Gjykata ne analize te provave te paraqitura prej paleve ne gjykim cmon se:

I. Kerkesa u paraqit ne zbatim te nenit 3 te Ligjit Nr.10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, te titulluar “Fusha e zbatimit”.

Sipas pikes 1 te ketij neni, ligji gjen zbatim per pasurite e personave mbi te cilet ekziston nje dyshim i arsyeshem, bazuar ne indicje, per kryerjen prej tyre te nje sere veprash penale ne te cilat perfshihet edhe vepra penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (germa “d” e kesaj pike).

U provua ne gjykim se shtetasit M. G., S. G. dhe R. G. jane persona nen hetim per kryerje te vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepreve penale”, per te cilen eshte duke proceduar Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Gjirokaster.

Sipas Aktit te Ekspertimit Kontabel te kryer me date xxxx nga eksperti

kontabel i licensuar Gj. H., akt ky i plotesuar me Aktin e Ekspertimit Kontabel te dates xxxx, rezultoi se shtetasit S. G., M. G. e R. G., per periudhen qe i'u nenshtrua ekspertimit kontabel, nga data xxxx deri me xxxx, si rezultat i punes ne emigracion, por edhe si rezultat i huamarrjes nga te tretet kane realizuar te ardhura ne shumen xxxx (xxxx) euro. Per kete periudhe ato kane patur shpenzime ne vleren xxxx (xxxx) euro.

Per pasoje, rezulton se diferenca e te ardhurave me shpenzimet per keta shtetas **(perfitimet e mundshme ose te ardhurat neto) per periudhen nenshtruar shqyrtimit gjyqesor eshte ne shumen xxxx (xxxx) euro.**

Ekspertimit kontabel i'u nenshtrua edhe aktiviteti me te cilin realizojne te ardhurat shtetasit L. B. e E. M., nga ku rezultoi se:

“Lidhur me subjektin tregtar “xxxx” sh.p.k., sipas ekstraktit te regjistrimit tregtar te Q.K.R., ky subjekt i identifikuar me NIPT xxxx eshte regjistruar me date xxxx... Objektiviteti i veprimtarise eshte ne fushen e ndertimeve dhe rikonstruksionit te ndertimeve te kadegorive te ndryshme, gjeologjike, hidraulike e kanalizimeve, tregtim mallra industrial dhe material ndertimi. Administrator i kesaj shoqerie L. B.. O. L. B. e E. Sh. x% me x%.

Qarkullimi vjetor sipas levizjeve ne llogarine bankare prane bankare prane xxxx Bank gjate vitit xxxx ne shumen xxxx leke.

Ky subjekt ka patur nje llogari bankare me nr. xxxx ne monedhen Euro prane xxxx Bank, e cila gjate vitit xxxx, vetem gjate kater mujorit te pare te ketij viti te kete realizuar nje xhiro ne shumen xxxx euro, ose e konvertuar ne shumen xxxx leke, qe se bashku me xhiron e cilesuar me lart arrin ne shumen xxxx leke...

Gjithashtu rezulton se “xxxx” sh.p.k., ne nr. e llogarise xxxx ne euro prane kesaj banke rezulton te kete kryer transaksione blerje x apartamente ne shumen xxxx euro, me date xxxx ne shumen xxxx euro, dhe ne date xxxx ne shumen xxxx euro.”

Per kete subjekt, me kerkese te prokurorit, u moren dhe u administruan edhe bilancet financiare per vitet 2010-2013.

Lidhur me aktivitetin qe realizon te ardhurat shtetasi E. M., nga eksperti kontabel eshte konkluduar se:

“Lidhur me subjektin tregtar “xxxx” SH.P.K., sipas Aktit te regjistrimit tregtar te Q.K.R.-se, ky subjekt identifikuar me NIPT xxxx eshte regjistruar me date xxxx... Objektiviteti i tregtise eshte import eksport i produkteve

ushqimore e industrial, hidraulike, servise, bar kafe, etj. Ortak i vetem i kesaj shoqerie eshte z. E. M..

Ne aktivitetin e kesaj shoqerie per vitin 2013 vleresohet nje qarkullim vjetor ne shumen xxxx leke prane xxxx Bank, ne nr. e llogarise xxxx... ”.

Per sa me siper, rezulton e provuar se huadhenesit, shtetasit L. B. e E. M. i kane patur mundesite financiare per te dhene hua shumate e sipermsheuara.

II. Ne interpretim dhe zbatim te nenit 24 te ligjit, gjykata çmon se per vendosjen e mases se konfiskimit mbi pasurite eshte e domosdoshme te plotesohen te gjitha kushtet e parashikuara ne piken 1 te tij: **a.** Kur ka dyshime te arsyeshme, te bazuar ne indicje, per pjesmarrjen e personit ne veprimtari kriminale te parashikuara ne nenin 3 te ketij ligji. **b.** Kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje te ligjshme, apo personi nuk justifikon zoterimin e pasurive ose te te ardhurave qe nuk i pergjigjen dukshem nivelit te te ardhurave, fitimeve apo veprimtarive te ligjshme, te deklaruar dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe **c.** Kur rezulton se pasuria eshte drejtperdrejt ose terthorazi ne zoterim te pjesshem apo te plote te personit. |

Mungesa e te pakten njerit prej kushteve te sipermsheuara, te parashikuara ne germet “a” dhe “b” dhe “c” te pikes “1” ketij neni, ben qe gjykata te mos marre masen parandaluese te konfiskimit.

Ne vleresim te provave te marra e te nenshtuara shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar se pasuria (e cila kerkohej te konfiskohej) e shtetasve S. G., M. G. e R. G. ka prejardhje te ligjshme, pasi keta persona justifikuan zoterimin e vlerave monetare te sekuestruara e te kerkuara per konfiskim, te cilat u pergjigjen dukshem nivelit te te ardhurave, fitimeve apo veprimtarive te ligjshme, te deklaruar.

Gjykata çmon se vlerat monetare sekuestruar shtetasve S. G., M. G. e R. G., nuk duhet te konfiskohet pasi mungon kushti i parashikuar ne germen “b” te pikes “1” ketij nenit 24 te ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

Ne disponimin e saj, gjykata merr ne konsiderate qendrimin e perfaqesuesit te Prokurorisë prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, prokurorit Edvin Kondili, i cili ne bisedimet perfundimtare, ne baze te nenit 201 te K.Pr.Civile kerkoi: heqjen dore nga gjykimi i kerkeses se padise dhe pushimin e gjykimit ndaj shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., pasi gjate gjykimit nuk u be e mundur te provohet se shuma prej xxxx euro eshte fituar nga veprimtari e paligjshme; si dhe revokimin e

sekuestros per shumate monetare:

1. Prej xxxx (xxxx) euro, qe ndodhen ne Banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., e datelindjes xxxxx.
2. Prej xxxx (xxxx) euro, ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx, ne Banken xxxx.
3. Prej xxxx (xxxx) euro, ne emer te shtetasve R. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx ne Banken xxxx.

Pika 1 e nenit 201 te K.Pr.Civile parashikon se:

“Paditesi ne cdo faze te gjykimit mund te heqe dore nga gjykimi i padise. Ne kete rast gjykata vendos pushimin e gjykimit.”

Pika 4 e nenit 7 i ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009, parashikon se:

*“Per njoftimet, afatet dhe **proceduren e gjykimit** zbatohen, per aq sa jane te pajtueshme rregullat e Kodit te Procedures Civile.”;*

si dhe pika “1” e nenit 22 te tij parashikon se:

“Gjate gjykimit te kerkeses per konfiskim zbatohen, per aq sa eshte e mundur dispozitat e Kodit te Procedures Civile”.

Ndodhur ne keto kushte, kur paditesi (prokuroria) hoqi dore nga gjykimi i kerkeses se padise, gjykata disponon me pushimin e gjykimit te kerkeses per konfiskim, duke revokuar masen e sekuestros vendosur me vendimin Nr. x date xxxx te saj.

Ne baze te pikes 5 te nenit 28 ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, kompetente per ekzekutimin e vendimit te konfiskimit apo revokimit te pasurive te sekuestruara jane permbaruesit gjyqesor. Ne keto kushte, eshte detyrim ligjor per gjykatën qe ne vendimin e saj te urdheroje zyren e permbarimit, ne juridiksionin e te ciles ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit te Procedures Civile), per zbatimin e vendimit te revokimit te pasurive te sekuestruara.

PER KETO ARSYE

Gjykata, ne baze te nenit 21, nenit 24 pika1, nenit 25, nenit 27 pika 2, nenit 28 pika 5, te Ligjit Nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, si dhe nenit 201 te K.Pr.Civile.

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit te kerkeses nr. 5/32 regjistri themeltar date 31.12.2014 te Prokurorise prane Gjykeses se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me objekt: *“Konfiskimin e shumave monetare te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G..”*
- Revokimin e mases se sekuestros mbi shumat monetare te shtetasve M. G., S. G. dhe R. G., e konkretisht te:
 - 1. Shumes xxxx (xxxx) euro**, qe ndodhen ne banken xxxx, ne llogarine e shtetases R. R., e datelindjes xxxx.
 - 2. Shumes xxxx (xxxx) euro**, ne emer te M. G., ne llogarine me numer xxxx, ne banken xxxx.
 - 3. Shumes xxxx (xxxx) euro**, ne emer te shtetasve R. G. dhe S. G., ne llogarine me numer xxxx, ne banken xxxx.
- Per ekzekutimin e revokimit te mases se sekuestros ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor ne xxxx.
- Shpenzimet proceduriale gjyqesore i ngarkohen paleve siç i kane bere.
- Kunder vendimit lejohet e drejta e ankimit te veçante, brenda afatit ligjor, ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

U shpall sot ne Tirane, ne date 27.07.2015.

SEKRETARE

Jerina SKRAPARI

GJYQTARE

Etleva DEDA

